

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

**OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I GODINES SE PREFEKTIT BERAT**

**QËLLIMI I PROJEKTIT ESHTË NDERHYRJA NE ZEVENDESIMIN E DRITAREVE EKZISTUESE PER RRRITJEN E EFICENSES ENERGJITIKE DUKE ZEVENDESUAR DRITARET EKZISTUESE ME DRITARE D/A PLASTIKE DOPIOXHAM.**

Duke parë dhe analizuar me kujdes gjendjen ekzistuese te dritareve te objektit është vlerësuar gjendja teknike nisur nga fakti se dritaret eksistuese jane vendosur qe me ndertimin e objektit dhe nder vite nuk eshte nderhyre per mirembajtje te tyre. Dritaret nga kushtet atmosferike jane shume te demtuara dhe lejojne ujrat e shiut te futen brenda ne godine si pasoje e amortizimit te silikonit dhe gominave te tyre.

Në të gjithë elementët përbërës të dritareve të ndërtesës do zbatohen kriteret më të përparuara në drejtim të funksionit dhe materialet me standarte bashkëkohore në fushën e ndërtimeve.




## I.G.JENDJA EKZISTUESE

### *Vendndodhja: Berat*

**Përshkrim:** Kjo godinë që në momentin që është ndërtuar dhe deri tani ka shërbyer si ambiente pune për administratën shtetërore.

Godina është katër katëshe, është godinë e përbashkët me alb-telekomin, Raiffeisen bank, BKT dhe Hotelin “Republika”. Dritaret ekzistuese janë shumë të demtuara dhe lejojnë ujrat e shiut të futen brenda në godinë si pasojë e amortizimit të silikonit dhe gominave të tyre nga kushtet atmosferike.

Është menduar zëvendësimi i dritareve të zyrave zëvendësimi i dritareve ekzistuese të tualeteve të katit të tretë e të katërt me dritare duralumini plastike dopio zham.



Dere d/a plastike dopio zham

## SPECIFIKIME TEKNIKE

### 2.375/1 F.V dritare d.alimini plastike dopio xham

Punimet do te perqendrohen ne heqjen e dritareve ekzistuese dhe zevendesimi me dritare d/a plastike dopio zham, xhami i jashtem do te jete termik me spesor 4mm, dhe xhami i brendshem do te jete i thjeshte me spesor 4 mm.

Punimet duhet te kryhen me kujdes dhe gjate heqjes se dritareve ekzistuese te mos demtohen muret e objektit .

Dritaret qe do te hiqen do te magazinohen ne nje ambient i percaktuar nga investitori (Prefekti i qarkut).

Dritaret e godines se prefektit jane projektuar me hapesire drite dysHEME tavan dhe jane me nje kanate dhe nje pjese fikse (e palevizur)

Do te behet furnizimi dhe vendosja e dritareve ne ambientet zyrove te administrates e tualeteve te katit te trete dhe te katert te godines. Ngjyra e dritareve duhet ti pershatetet ngjyres se duralumineve ekzistues ne menyre qe dritaret te jene ne harmoni me pjesen tjeter te godines.


Korniza fikse e dritares do të ketë një dimension te tille sipas dritareve ekzistuese. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejne për rrëshqitjen e skeletit të dritares.



Dritare te reja  
W<sub>0</sub>

Dritaret e katit te  
drita e te trete

## **2.395/1 F V dyer d/alumini plastike me dopio xham**



Dere d/a plastike dono zham

Instalimi i deres duralumini/plastike ne hyje te Institucionit, do të bëhen me anë të montimit të profileve të duralumini standartit European EN 573 - 3, pjesa e deres do te jete ne mes te hapsire dhe tjesa tjeter do te realitohet me dopioxham te fiksuar ne strukture.

### **Lyerje me bojë akrelik i sipërfaqeve të jashtme (Fasada)**

Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar(Astarplastik).Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke bërë përzierje ne 1kg vinovil të Holluar me 3 litër ujë. Mepërzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1litër vinovil i holluar që duhet të përdoret për 20m<sup>2</sup> sipërfaqe.

Më pas vazhdohet me lysterjen me bojë akrelik. Kjo bojë ndryshon nga boja plastike sepse ka në përbërjen e saj vajra të ndryshme, të cilat e bëjnë bojën rezistente ndaj rrezeve të diellit, ndaj lagështirës së shirave, etj.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës akrelik me ujë. Lëngu i bojës hullohet me ujë në masën 20-30%. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar. Pastaj, bëhet lysterja e sipërfaqes. Lysterja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë akrelik i holluar në 4-5 m<sup>2</sup> sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyster).

Personeli, që do të kryejë lysterjen duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lysterjes të KTZ dhe STASH.